



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2015

(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Lënda: Dërgohet raporti vjetor

Drejtuar: INSPEKTORIATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës suaj, po Ju dërgojmë raportin vjetor për veprimtarinë e kryer nga Autoriteti Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9049, datë, 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar

Në zbatim të pikës 3, nenit 42, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar dhe pikës 7, të Udhëzimit nr.1, datë 27.06.2014 "Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike", bashkëngjitur kësaj shkresë dërgohet raporti vjetor për veprimtarinë e kryer nga Autoriteti Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave. Në zbatim të nenit 3, pika gj, të ligjit nr.9049, datë, 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar, dërgohet lista e zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Në listën e zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave janë: znj. Rezana Vrapit në pozicionin Drejtore e Përgjithshme, z. Arben Fagu në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Bazës së të Dhënave dhe Sistemeve, znj. Antonieta

Luli në pozicionin Drejtore në Drejtorinë e Vlerësimit të Arritjeve, znj. Heliona Miço në pozicionin Drejtore në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit. Bazuar në strukturën organike të miratuar me Urdhrin nr. 99, datë 21.02.2014 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Provimeve", nuk ka asnjë pozicion vakant në listën e funksioneve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike. Bashkëngjitur kësaj shkrese dërgohet lista emërore e zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike dhe regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së rasteve të konfliktit të interesave.

Për çdo informacion jeni të lutur të kontaktoni me autoritetin përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave dhe z. Agim Alia si person kontakti, në adresën: AKP, Rruga Naim Frashëri, nr.37, Tiranë, Tel: + 355 4 2419257, e-mail gim_alia@yahoo.com

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Me respekt,

Rezana VRAPI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Raporti vjetor për veprimtarinë e kryer nga Autoriteti Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave

1. Kuadri ligjor:

Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) është krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve" si një institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arrietjeve, të pranimit në shkollat e larta dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit, të pranimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit. Gjithashtu me Urdhrin nr. 99, datë 21.02.2014 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Provimeve" është miratuar struktura dhe organika e IZHA-s.

AKP në ushtrimin e veprimtarisë së saj mbështetet në legjislacionin në fuqi, në ligjet për arsimin parauniversitar dhe atë të lartë dhe njëkohësisht në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto fusha si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, rregulloren e brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

AKP në veprimtarinë e saj zbaton ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

2. Ngritja dhe funksionimi i Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave:

AKP bazuar në nenin 41, pika 2 e ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, i ndryshuar, me urdhër nga titullari i institucionit ka ngritur Autoritetin Përgjegjës (AP) për parandalimin e konfliktit të interesave si strukturë e veçantë e cila do të mbajë në vijimësi marrëdhëniet dhe kontaktet me ILDKPKI. Autoriteti Përgjegjës përbëhet nga tre veta dhe drejtues i njësisë Autoritet Përgjegjës është caktuar përgjegjësi i sektorit të shërbimeve mbështetëse.

Dy anëtarët e tjerë janë juristi i institucionit dhe specialist nga sektori i administrimit të testit, analizës dhe psikometrisë.

3. Parandalimi, kontrolli dhe zgjidhja e gjendjeve të konfliktit të interesave:

Autoriteti Përgjegjës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave:

a) Për procesin e deklarimit të interesave private periodike:

- i. Është bërë njoftimi, dhënia e konsulencës dhe dorëzimi i deklaratave të interesave private si dhe respektimi i afateve ligjore nga ana e tyre.
- ii. Në zbatim të nenit 3, pika gj, të ligjit nr.9049, datë,10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar, në listën e zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive janë: znj. Rezana Vrapit, në pozicionin Drejtore e Përgjithshme, kategoria II-a, z. Arben Fagu, në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Bazës së të Dhënave dhe Sistemeve, kategoria II-b, znj. Antonieta Luli në pozicionin Drejtore në Drejtorinë e Vlerësimit të Arritjeve, kategoria II-b dhe znj. Heliona Miço në pozicionin Drejtore në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit, kategoria II-b.
- iii. Nuk është evidentuar asnjë rast i mosrespektimit të afateve ligjore për dorëzimin e deklaratave të interesave private.
- iv. Nuk është evidentuar asnjë rast i marrjes së masave disiplinore për shkelje të konstatuara të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe ligjit nr.9367, datë 07.04.2005.

b) Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave:

- i. Në zbatim të nenit 10, pika 2 është lëshuar autorizimi nga ana e të gjithë punonjësve në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ata e autorizojnë institucionin që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin kudo ku ato janë regjistruar. Ndërsa autorizimi nga ana e drejtorit të AKP-së i është lëshuar institucionit epror, përkatësisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- ii. Gjatë vitit 2015 janë evidentuar dhe regjistruar raste të konfliktit të interesave.

- iii. Lidhur me rastet e verifikuara dhe të kontrolluara për konflikt interesi, informojmë si vijon:
Në zbatim të nenit 6, të Rregullores “Për procesin e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin parashikohet: *“personat e përfshirë në të gjitha nivelet e administrimit të provimeve të Maturës Shtetërore, deklarojnë me shkrim që nuk kanë fëmijë, nipër, mbesa, motër, vëlla, maturanë/kandidatë që do të japin provimet e Maturës 2015”*, Drejtori i Përgjithshëm dhe 5 (pesë) punonjës të AKP-së kanë bërë vetë deklaram, duke i dërguar deklaratën e konfliktit të interesave Drejtorit të Përgjithshëm dhe KOMSH-it, të cilët do të vendosin rast pas rasti lidhur me rastet kur nuk mund të përfshihen në procesin e MSH. Të gjithë punonjësit e tjerë kanë plotësuar deklaratat me shkrim se nuk kanë fëmijë, nipër, mbesa, motër, vëlla, maturanë/kandidatë që do të japin provimet e Maturës 2015.
- iv. Lidhur me trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave informojmë si vijon:
Drejtori i Përgjithshëm i AKP-së me shkresën nr.522/1 prot., datë 26.02.2015 i ka dërguar Komitetit të Maturës Shtetërore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit deklaratën e interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike duke e informuar se ka vazhën maturanë/kandidate që do të japë provimet e MSH 2015. Në përgjigje të shkresës së mësipërme Ministria e Arsimit dhe Sportit ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1689/1 prot., datë 02.04.2015, duke e informuar se nuk mund të marrë pjesë në asnjë nivel administrimi të këtij procesi dhe duke caktuar drejtoreshën e Drejtorisë së Vlerësimit të Arritjeve në AKP, si personin përgjegjës për administrimin në të gjitha nivelet e procesit të MSH 2015.
Me shkresën nr.448/1 prot., datë 30.03.2015, i janë dërguar Komitetit të Maturës Shtetërore dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit deklaratat e interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike të 5 (pesë) punonjësve të AKP-së, duke i informuar se kanë fëmijë, nipër, mbesa, motër, vëlla, maturanë/kandidatë që do të japin provimet e Maturës 2015. Me shkresën nr.448/2, datë 03.04.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së, 3 (tre) punonjës janë informuar se nuk mund të përfshihen në asnjë nga fazat e MSH 2015, ndërsa 2 (dy) punonjëse janë informuar se nuk mund të përfshihen në procesin e hartimit të testit përfundimtar, por do të jenë pjesë e fazës kur hartohet skema e vlerësimit për MSH 2015, me qëllim shmangin e çdo lloj konflikt interesi.
Me shkresën nr.1199 prot. datë 24.06.2015 drejtuar ILDKPKI, kemi dërguar të gjithë informacionin mbi verifikimin dhe kontrollimin e rasteve për konflikt interesi dhe mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së tyre dhe dokumentacionin përkatës.
- v. Vëmë në dijeni se nuk ka patur raste konfliktit të interesave të pazgjidhura të raportuara në ILDKPKI, gjykatë, prokurori.

4. Roli këshillues dhe trajnues i Autoritetit Përgjegjës:

Në kryerjen e veprimtarisë sonë jemi përpjekur që të ndihmojmë punonjësit dhe eprorët për çështjet dhe momentet kur ata duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e konfliktit të interesave. Të gjithë punonjësit i kemi informuar dhe këshilluar lidhur me ligjin nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së, nr.45, datë 27.10.2014 është miratuar rregullorja e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Rregullorja e brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe rregullorja e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit në internet.

Duke shprehur konsideratën tonë më të lartë,

Me respekt,

Për Autoritetin Përgjegjës:

- a. z. Eduard Meçaj, me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse
- b. znj. Eglantina Shtylla, me detyrë specialiste në Sektorin e Administrimit të Testit, Analizës dhe Psikometrisë
- c. z. Agim Alia, me detyrë jurist